



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 3053/prot.

Tiranë, më 24.04.2023

URDHËR

Nr. 300, datë 24. 04. 2023

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË PRIVATË QË USHTROJNË VEPRIMTARINË NË TERRITORIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Numri i përgjithshëm i përmbaruesve gjyqësorë privatë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, të jetë 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër).
2. Ngarkohet struktura përgjegjëse për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

ULSI MANJA

